

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal**, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarëve Sh.D dhe A.D qe te dy nga ..., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.596/2017 të dt.23.03.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit Themelor në Prizren, Elfete Purova, të akuzuarit, me datë **27.02.2018**, morri dhe shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

**1.I akuzuari – Sh.D**, nga i ati A..., e ëma N..., e vajzerise ..., i lindur më dt.... në ..., ku edhe jeton ne rr.... nr...., i martuar baba i 3 femijeve, fakultetin ekonomik te kryer, menagjer sigurimi, i gjendjes se mesme ekonomike, turk, shtetas i R. së Kosovës.

**2.I akuzuari – A.D**, nga i ati Sh..., e ëma A..., e vajzerise ..., i lindur më dt.... në Prizren, ku edhe tani jeton ne rr.... nr...., i martuar baba i 1 femiu, me profesion kepuctar, ka të kryer shkollen e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, turk, shtetas i R. së Kosovës.

### JANË FAJTOR

I akuzuari **Sh.D e A.D**,

Se me dt. 04.03.2017 rreth ores 20,45 min, ne spitalin rajonal ne Prizren, te pandehurin seriozisht e kanosin te demtuarin Sh.H (anestezist), ne ate menyre qe derisa i pandehuri Sh. kishte derguar djalin e tij te pandehurin A., per ta vizituar ne spitalin rajonal ne Prizren, dhe pas kontrollit derisa i demtuari i tregon se duhet ta paguaj shumen prej 10 eurove, gjate regjistrimit pasi qe nuk kishte udhezim, i pandehuri Sh.D i drejtohet me fjalet:”kush je ti qe me lyp pare, ti je hajn, ti nuk je normal, ta q... nenen”, ku me pas i pandehuri A. i drejtohet me fjalet:”te pres me dal jashte, dhe e sheh se çka kemi me te ba”, me ç’rast te i demtuari shkakton frike, ankth dhe pasiguri,

-kësodore ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49, 50, 73, 74, 75 e 76 dhe 365 par.1 te KPK-es te akuzuarëve iu shqipton:

Te akuzuarit **Sh.D**

### D E N I M M E K U S H T

Ashtu qe i verteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6 muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej **1 (nje) viti**, nga dita e plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk do te kryen ndonjë vepër të re penale.

Te akuzuarit **A.D**

## D E N I M M E K U S H T

Ashtu qe i verteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6 muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej **1 (nje) viti**, nga dita e plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk do te kryen ndonjë vepër të re penale.

Te akuzuarit obligohen që ti paguajne shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates sado qe te behen ato, si dhe ne emer te paushallit gjyqesor secili veç e veç shumen me nga **30,00 euro**, ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtuar aktakuzen me PP.nr.596/2017 te dt. 23.03.2017, kunder te akuzuareve Sh.D e A.D qe te dy nga ..., per shkak te vepres penale kanosje nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Gjykata ne shqyrtim kryesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuareve te cilet vullnetarisht e kane pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se te akuzuarit e kane kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesis per vepren penale e cila iu vihet ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat te akuzuarit kane qene te njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuareve eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuzen, ne veprimin e te akuzuareve formohen te gjitha tiparet dhe elementet e vepres penale kanosje nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-es, dhe per kete gjykata te akuzuarit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënimin me kusht, paraprakisht duke iu vertetuar pergjegjesine e tyre penale-juridike.

Me rastin e caktimit te dënimit ndaj te akuzuareve gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e dënimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuareve, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tyre, ne kuptim te nenit 74, 75 e 76 te KP-es, gjykata morri per baze edhe faktin se te akuzuarit kane bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tyre ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, kane pranuar fajesin dhe kane hprehur keqardhje per veprat penale, deri me tani te pa gjykuar, çka nenkupton se nuk kane ardhur ndesh me rregullat pozitive, mbajtes te familjeve disa anetaresh, publikisht i kerkojne falje te demtuarit dhe deshirojne qe ta gjejne gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, andaj gjykata iu shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me shqiptimin e dënimit do te arrihet qellimi i dënimit, prandaj iu shqipton dënimin me burgim ne kohezgjatje secilit veç e veç me nga 6 (gjashte) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nese ne afatin prej 1 (nje) viti, nuk kryejne veper te re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tyre dhe me kete dënim do te arrihet qellimi i dënimit, e qe te akuzuarit ne te ardhmen te jene te kujdesshem dhe te permbahen nga veprimet e tilla te karakterit penal.

Vendimimbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 451 par.1 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 649/2017 të dt. 27.02.2018**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.